



Ortaokul

ARNAVUTÇA 7

Öğretim Materyali

Yazarlar:

Arş. Gör. Ece DILLIOGLU

Öğr. Gör. Rijetë SIMITÇIU

Arş. Gör. Tolga DILLIOGLU



DEVLET KİTAPLARI

BİRİNCİ BASKI

2019

MİLLÎ EĞİTİM BAKANLIĞI YAYINLARI	: 7190
YARDIMCI VE KAYNAK KİTAPLAR DİZİSİ.....	: 1319

Her hakkı saklıdır ve Millî Eğitim Bakanlığına aittir. Kitabın metin, soru ve şekilleri kısmen de olsa hiçbir surette alınıp yayımlanamaz.

■ **Genel Koordinatör:**

Prof. Dr. İlker ALP

■ **Koordinatörler:**

Dr. Öğr. Üyesi Seda TAŞ,

Dr. Öğr. Üyesi Şahin KILIÇ,

Dr. Öğr. Üyesi Ferhan KIRLIDÖKME MOLLAOĞLU

■ **Editörler:**

Dr. Öğr. Üyesi Ilir RRUGA

Arş. Gör. Ece DİLLİOĞLU

Prof. Dr. Zekjir KADRIU

■ **Seslendirenler:**

Arş. Gör. Tolga DİLLİOĞLU

Arş. Gör. Ece DİLLİOĞLU

■ **Grafik Tasarım:**

Emre Mahir KILIÇER

■ **Görsel Tasarım:**

Derya ÜN

ISBN 978-975-11-5128-5

Millî Eğitim Bakanlığı, Talim ve Terbiye Kurulunun 18.09.2019 gün ve 17449800 sayılı kararı ile eğitim aracı olarak kabul edilmiş, Destek Hizmetleri Genel Müdürlüğünün gün ve sayılı yazısı ile birinci defa adet basılmıştır.



İSTİKLÂL MARŞI

Korkma, sönmez bu şafaklarda yüzen al sancak;
Sönmeden yurdumun üstünde tüten en son ocak.
O benim milletimin yıldızıdır, parlayacak;
O benimdir, o benim milletimindir ancak.

Çatma, kurban olayım, çehreni ey nazlı hilâl!
Kahraman ırkıma bir gül! Ne bu şiddet, bu celâl?
Sana olmaz dökülen kanlarımız sonra helâl,
Hakkıdır Hakk'a tapan milletimin istiklâl.

Ben ezelden beridir hür yaşadım, hür yaşarım.
Hangi çılgın bana zincir vuracakmış? Şaşarım!
Kükremiş sel gibiyim, bendimi çiğner, aşarım.
Yırtarım dağları, enginlere sığmam, taşarım.

Garbın âfâkını sarmışsa çelik zırhlı duvar,
Benim iman dolu göğsüm gibi serhaddim var.
Ulusum, korkma! Nasıl böyle bir imanı boğar,
Medeniyet dediğin tek dişi kalmış canavar?

Arkadaş, yurduma alçakları uğratma sakın;
Siper et gövdeni, dursun bu hayâsızca akın.
Doğacaktır sana va'dettiği günler Hakk'ın;
Kim bilir, belki yarın, belki yarından da yakın.

Bastığın yerleri toprak diyerek geçme, tanı:
Düşün altındaki binlerce kefensiz yatanı.
Sen şehit oğlusun, incitme, yazıktır, atanı:
Verme, dünyaları alsan da bu cennet vatanı.

Kim bu cennet vatanın uğruna olmaz ki feda?
Şüheda fışkıracak toprağı sıksan, şüheda!
Cânı, cânânı, bütün varımı alsan da Huda,
Etmesin tek vatanından beni dünyada cüda.

Ruhumun senden İlahî, şudur ancak emeli:
Değmesin mabedimin göğsüne namahrem eli.
Bu ezanlar -ki şehadetleri dinin temeli-
Ebedî yurdumun üstünde benim inlemeli.

O zaman vecd ile bin secde eder -varsa- taşım,
Her cerihamdan İlahî, boşanıp kanlı yaşım,
Fışkırır ruh-ı mücerret gibi yerden na'sım:
O zaman yükselerek arşa değer belki başım.

Dalgalar sen de şafaklar gibi ey şanlı hilâl!
Olsun artık dökülen kanlarımın hepsi helâl.
Ebediyyen sana yok, ırkıma yok izmihlâl;
Hakkıdır hür yaşamış bayrağımın hürriyyet;
Hakkıdır Hakk'a tapan milletimin istiklâl!

Mehmet Âkif Ersoy


GENÇLİĞE HİTABE

Ey Türk gençliği! Birinci vazifen, Türk istiklâlini, Türk Cumhuriyetini, ilelebet muhafaza ve müdafaa etmektir.

Mevcudiyetinin ve istikbalinin yegâne temeli budur. Bu temel, senin en kıymetli hazinendir. İstikbalde dahi, seni bu hazineden mahrum etmek isteyecek dâhilî ve hâricî bedhahların olacaktır. Bir gün, istiklâl ve cumhuriyeti müdafaa mecburiyetine düşersen, vazifeye atılmak için, içinde bulunacağın vaziyetin imkân ve şeraitini düşünmeyeceksin! Bu imkân ve şerait, çok namüsaît bir mahiyette tezahür edebilir. İstiklâl ve cumhuriyetine kastedecek düşmanlar, bütün dünyada emsali görülmemiş bir galibiyetin mümessili olabilirler. Cebren ve hile ile aziz vatanın bütün kaleleri zapt edilmiş, bütün tersanelerine girilmiş, bütün orduları dağıtılmış ve memleketin her köşesi bilfiil işgal edilmiş olabilir. Bütün bu şeraitten daha elîm ve daha vahim olmak üzere, memleketin dâhilinde iktidara sahip olanlar gaflet ve dalâlet ve hattâ hıyanet içinde bulunabilirler. Hattâ bu iktidar sahipleri şahsî menfaatlerini, müstevlîlerin siyasî emelleriyle tevhit edebilirler. Millet, fakr u zaruret içinde harap ve bîtap düşmüş olabilir.

Ey Türk istikbalinin evlâdı! İşte, bu ahval ve şerait içinde dahi vazifen, Türk istiklâl ve cumhuriyetini kurtarmaktır. Muhtaç olduğun kudret, damarlarındaki asil kanda mevcuttur.

Mustafa Kemal Atatürk



MUSTAFA KEMAL ATATÜRK

PËRMBAJTJE




► 7

77 ◀



► 17

87 ◀



► 29

97 ◀



► 41

107 ◀



► 53

119 ◀



► 65

129 ◀



MËSIMI 1



MIQËSIA

1. Lexoni tekstin dhe mundohuni ta kuptoni.

libër

ALBA DHE ANA

Alba ka një shoqe në Tiranë. Shoqja e Albës quhet Ana. Alba dhe Ana janë moshatare. Ato janë dy shoqe shumë të ngushta. Çdo verë ato vizitojnë njëra-tjetrën. Këtë verë Alba do të vizitojë Anën. Prindërit e Anës kanë shtëpi në Tiranë. Ata janë shumë mikepritës. Ana ka një motër. Motra e saj quhet Alisa. Ajo është mësuese dhe punon në shkollë.

Alba është turke. Ajo është studente e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Ana është shqiptare. Ajo është studente në gjuhën turke. Alba mëson shqip dhe Ana mëson turqisht. Ato e ndihmojnë njëra-tjetrën për të mësuar gjuhën.

2. Shkruani kuptimet e fjalëve të cilat i keni mësuar më parë. Ato që nuk i dini i mësoni nga fjalori.

Shoqe:	Moshatare:
Të ngushtë:	Verë:
viziton:	Shtëpi:
Mikepritës:	Motër:
Mësuese:	Shkollë:
Studente:	Ndihmë:

3. Lexoni fjalet e urta në lidhje me miqësinë. Shënoni cila është më e afër me mendimet e juaj.

libër



- Nëse bëhesh mik me veten, nuk do të jesh kurrë i vetmuar.
- Miqtë e vërtetë qajnë kur ti ikën, miqtë falso ikin kur ti qan.
- Miku i vërtetë është ai që kur të mban për dore, zemrën ta prek.
- Ai që kërkon mikun pa të meta, pa miq do të mbetet.

4.

Tregoni çfarë karakteri doni që shokū/shoqja e juaj të ketë. Shkruani në kutira po ose jo.



 xheloz/e

i/e dashur

I keq / e keqe

i/e vendosur

aventurier

bujar/e

i/e drejtë

agresiv/e

i ndershëm / e ndershme

serioz/e

egoist/e

besnik/e

kokëfortë

i/e pasigurt

i sjellshëm / e sjellshme

5.

Përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit në ushtrimin 1.



1. Nga është shoqja e Albës?

2. Si quhet shoqja e Albës?

3. A janë Alba dhe Ana moshatare?

4. A janë ato shoqe të ngushta?

5. Nga është Alba?

6. Nga është Ana?

7. Çfarë gjuhe mëson Alba?

8. Çfarë gjuhe mëson Ana?

9. Sa motra ka Ana?

10. A janë prindërit e Anës mikëpritës?

6. Tregoni çfarë ju pëlqen të bëni me shokët/shoqet?

- Shëtitje me shokët/shoqet Të bëjmë piknik Të festojmë
- Të bëjmë sport Të shkojmë në kinema Të lozim me lojëra

7. Dëgjoni me vëmendje dhe radhitni fjalitë duke krijuar një dialog. Pastaj dëgjoni dhe kontrolloni gabimet.









- Përsëndetje Bujar.
- Këtë fundjavë!
- Në cilën ditë dhe në çfarë ore?
- Mirë Drita. Shihemi të Shtunën.
- Përsëndetje Drita.
- Bujar, a do të shkojmë në kinema?
- Të shtunën, në orën 17.00.
- Po shkojmë. Kur të shkojmë?
- Mirupafshim.









1.
2.
3.
4.
5.
6.
7.
8.
9.



Karakteristikat e Horoskopit

		Pëlqen!	Nuk pëlqen!
 <p>Dashi</p>	<p>Fëmija që i përket shenjë së Dashi është shumë i gjallë e plot energji. Dallohet për këmbënguljen dhe pavarësinë. Dëshiron të jetë në lëvizje të vazhdueshme. Dëshiron të jetë qendra e vëmendjes që në moshë shumë të re. Në këtë pikë, prindërit e tij kanë nevojë të ndihmojnë fëmijët e tyre, pa qenë mbrojtës më shumë se çfarë duhet.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -ëmbëlirat -rrobat e reja -dhuratat -modën 	<ul style="list-style-type: none"> -të presë në radhë -kur të tjerët nuk e dëgjojnë -të hajë ushqime pa shije
 <p>Demi</p>	<p>Fëmija Dem është realist, i qetë dhe shumë i ndjeshëm. Kërkon siguri përreth që në moshë shumë të herët. Frikësohet nga ndryshimet përreth. Reagon dhe mendon ngadalë. Ndonjëherë është kokëfortë dhe nuk e ndërron mendjen lehtë. Ngrohtësia e familjes luan rol shumë të rëndësishëm në personalitetin e tij të mirë. Është një fëmijë që kërkon dialog dhe shpjegime për çdo gjë. Dhënia e dashurisë është një nga mënyrat për të zgjuar forcën e fëmijës së vogël Dem.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të kursejë para -të hajë ushqime të mira ngadalësinë 	<ul style="list-style-type: none"> -të shqetësohet kur bën një punë -të bëjë çdo ditë gjëra të reja -kur kërkojnë të tjerët të rritojë
 <p>Binjakët</p>	<p>Është një fëmijë shumë inteligjent dhe i komunikueshëm. Është shumë kurioz. Dëshiron të mësojë çdo gjë dhe bën shumë pyetje. Dëshiron të merret me shumë gjëra në të njëjtën kohë. Është e vështirë për të të përqendrohet në një gjë. Është fëmijë shumë i shoqërueshëm. Ka nevojë për shumë gjumë. Udhëtimet hapin horizonte në imagjinatën e tij. Librat do të tërheqin vëmendjen e tij që në moshë shumë të re.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të flasë në telefon -të vendosë pseudonime 	<ul style="list-style-type: none"> -të dëgjojë ankesat e njerëzve -të harxhojë kohën kot
 <p>Gaforrija</p>	<p>Është i ndjeshëm e romantik dhe gjen mënyra për të tërhequr vëmendjen tuaj duke qarë shpesh. Duhet të fitojë besimin tuaj dhe të ndihet i sigurt. Ata frikësohen nga tallja dhe refuzimi. Këta fëmijë janë shumë të lidhur me familjen e tyre dhe e gjejnë të vështirë të afrohen me njerëz jashtë shoqërisë së familjes.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -kur njerëzit e kujtojnë ditëlindjen tuaj -të organizojë festa 	<ul style="list-style-type: none"> -njerëzit që hamojnë ditët e rëndësishme -njerëzit që bërtasin
 <p>Luani</p>	<p>Është një fëmijë që dëshiron të bëhet qendra e vëmendjes. Është krijues, artist e i ndjeshëm dhe dëshiron të dallohet edhe nga mënyra se si vishet. Është krenar dhe i dashur dhe krijon grupe rreth vetes që e ndjekin dhe e respektojnë. Fëmijë me besim në vete të cilët nuk do ta pranojnë lehtë numrin dy. Lavdërimet dhe diplomacia kanë efekte pozitive për ta bërë vogëlushin të dëgjojë këshillat tuaja.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të jetë aktive -modën -të luajë përjashta 	<ul style="list-style-type: none"> -të jetë i mërzitur -të rrijë vetëm -moda e vjetër
 <p>Virgjëresha</p>	<p>Një fëmijë shumë i organizuar dhe praktik. I pëlqen rregulli dhe pastërtia. Shumë herë ai dëshiron të jetë i përsosur në mënyrë që të mos kritikohet. Është shumë i vëmendshëm. Ka aftësi të mëdha intelektuale. Adoptohet dhe mëson shpejt. Virgjëresha i vogël ka nevojë për durim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të bëjë lista -të jetë me disiplinë -kalshët e vogla 	<ul style="list-style-type: none"> -vendet me zhurmë -të uliet në një vend një kohë të gjatë

Karakteristikat e Horoskopit

		Pëlqeni	Nuk pëlqeni
 <p>Peshorja</p>	<p>Dashuron balancën e harmoninë. Kur ndihet i sigurt tregon anën e tij më të mirë. Është gjithmonë i gëzuar dhe i shoqërueshëm. Për një femijë Peshore është e lehtë të fajësojë të tjerët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të pikturojë -lavdërimet -dekoracionet e festave 	<ul style="list-style-type: none"> -njerëzit që bërtasin -vendet e shëmtuara -kritikimet
 <p>Akrepi</p>	<p>Është femijë i ndjeshëm. Ka nevojë për inkurajim për të shfaqur ndjenjat e tij. Femijë të fshehtë që dëshirojnë të fshehin mirë jetën e tyre private. Mënyra e tyre e komunikimit ndonjëherë e bën të vështirë për prindërit e tij. Ata urrejnë fyerjet dhe dhunën. Femija Akrep ndien më shumë nga sa mendon.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të ketë të drejtë -të fitojë -ta pëlqejnë 	<ul style="list-style-type: none"> -pyejet e shumta -të humbasë -problemet
 <p>Shigjetari</p>	<p>Është bujar, optimist dhe i shoqërueshëm. Dashuron udhëtimet. I pëlqen të jetë i pavarur. Ka tendencën për ta elcagjenuar. Humb para ose shikon me optimizëm të tepruar çdo gjë që dëshiron të arrijë. Mungesa e kontrollit për ushqimin dhe pijet mund t'i kthehet kundër ndonjëherë. Duhet të mësojë të mendojë përpara se të marrë një vendim dhe të jetë më i duruar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -parfumet -lavdërimet -të ndihmojë të tjerët 	<ul style="list-style-type: none"> -të mijë në një vend për shumë kohë -të bëjë premtime
 <p>Bricjapi</p>	<p>Është shumë serioz dhe i disiplinuar. Është i besueshëm dhe i duruar, përpiqet të kontrollojë sjelljen e tij dhe të mos shprehë anën e tij të ndjeshme. Duhet ta ndihmojë të mos ketë frikë të shprehë ndjenjat e tij. Le të mos harrojmë që megjithëse Bricjapët e vegjël nuk kërkojnë kurë ndihmë, ai patjetër që ka nevojë për dashuri e butësi për tu mirat.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të ndihet rehat -të ketë privatësinë tuaj 	<ul style="list-style-type: none"> -surprizat -të ndihet i vetmuar
 <p>Ujori</p>	<p>Është femijë me shpirt të lirë. Kërkon magjin e tij që në moshë të re. Kërkon një magje që është ndryshe nga ajo e të tjerëve. Dëshiron të jetë vetvetja, të zgjedhë stilin e tij. Ka shumë hobe dhe është shumë i shoqërueshëm. Femijës Ujor duhet t'i mësohet kontrolli i vetes. Ata mërziten shpejt nga rufina. Është një femijë i paparashikueshëm, prandaj duhet t'i qëndroni pranë pa e bërë të ndihet i trysur.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -të shpikë -surprizat -moda 	<ul style="list-style-type: none"> -personat mendjemedhenj
 <p>Peshqit</p>	<p>Ndien më shumë e mendon më pak. Është i edukuar. Duhet të respektohen momentet personale për imagjinatën e tij të fortë. Është një femijë shumë manipulues. Do të gjejë zgjidhje mes lotëve dhe fytës së tij të mërzitur. Një gjë tjetër që duhet të mësojë është të mos impresionohet lehtë. Çdo gjë që shkëlqen nuk është at.</p>	<ul style="list-style-type: none"> -ta duan -aromat -qirinjë -muzika 	<ul style="list-style-type: none"> -e shëmtuara -t'i thonë të kontrollojë emocionet

11.

Tregoni cili është horoskopi juaj. Përshkruani veten tuaj sipas karakteristikat e horoskopit.



Horoskopi im dhe karakteristikat

Handwriting practice area with ten horizontal lines for writing.

12.

Tregoni në klasë me gojë pastaj me shkrim, a mendoni se i keni të gjitha karakteristikat e horoskopit? Gjithashtu shprehni mendimet tuaja rreth horoskopit.



Handwriting practice area with ten horizontal lines, shaped like a cloud.

13. Detyrat



A series of horizontal blue lines for writing, spanning the width of the page.

A large white rectangular area with a dashed blue border, containing numerous horizontal dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and extend across the width of the page, providing a guide for handwriting practice.

MËSIMI 2



TELEVIZORI

1. Lexoni dhe mësoni historinë e televizorit.





Televizori shkurtimisht quhet "TV". Televizorin e ka zbuluar anglezi John Logie Baird dhe rusi Vladimir Zworykin në Amerikë në vitin 1926. TV-të janë shitur në mes të viteve 1928 dhe 1934 në Amerikë dhe Rusi. Dhe pastaj janë shitur në të gjithë botën. Sot njerëzit në Televizor shikojnë filma, seriale, filma vizatimor, dokumentar, lajme dhe programe.

2. Tregoni në klasë çfarë dini ju rreth televizorit. Mundohuni të bisedoni me shoqet/ shoket e klasës rreth kësaj teme.



3. Mësoni llojet e filmave me anë të ushtrimit të mëposhtëm. Bashkoni figurat me llojet e filmave.



Komedi

Dramë

Aksion

Të frikshëm

Aventurë

Fantashkencë

Biografi

Dokumentar

4. Tregoni cilat filma ju pëlqejnë më shumë.



Unë

Shoqja/Shoku

<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
---	---

5. Lexoni fjalitë dhe shkruani në vendet boshe programin televiziv të duhur.



“Nga këto programe mësojmë gjërat që ndodhin në botë dhe në shtetin tonë.”

1. _____

“Ka si qëllim dokumentimin e disa aspekte të realitetit.”

2. _____

“Kur i shikojmë këto filma trembemil!”

3. _____

“Në këto filma zakonisht shikojmë skena të dhunshme ose arratisjeje.”

4. _____

“Zakonisht në këto filma shikojmë robotë dhe shumë sende teknologjike.”

5. _____

“Këto filma janë për tëmiqe.”

6. _____

“Këto filma janë më pjesë të vazhdueshme.”

7. _____

“Kur i shikojmë këto filma qeshim.”

8. _____

“Këto filma na tregojnë për jetën e personave të rëndësishëm.”

9. _____



Aktori Turk Kemal Sunal ka lindur më 10 nëntor 1944 dhe ka vdekur në 3 korrik 2000. Ai ka fituar popullaritet të madh me filmat "Klasa Hababam", "Mbreti i Kujdestarëve" dhe "Davaro". Ka qenë i famshëm me karakterin e tij me emrin "Şaban". Në këtë rol ai ka luajtur shpesh.

Kemal Sunal shkollën e mesme e ka kryer në gjimnazin Vefa. Që në moshë të vogël ai filloi të lozi në role të vogla në teatro të ndryshme. Atë e njohën të gjithë dhe filloi të merre oferta për filma me buxhet më të madh. Pothuajse në të gjitha filmat e tij Kemal Sunal ka luajtur në rolin e një njeri të varfër.

Kemal Sunal gjithmonë veten e tij dhe familjen e ka mbajtur larg nga media. Njerëzit që e njihnin atë kanë thënë se ai në jetën e tij është shumë serioz.

Kemal Sunal vdiq më 3 korrik 2000 si pasojë e një infarkti në zemër në aeroplan.

7.

Pergjigjuni pyetjeve sipas tekstit të mesipërm.



1. Kush është Kemal Sunal?

2. Kur ka lindur Kemal Sunal?

3. Cilat janë filmat më të famshëm të tij?

4. Si quhet karakteri më i famshëm i tij?

5. Si e ka emrin gjimnazi që ka kryer Kemal Sunal?

6. Çfarë roll ka luajtur më shumë Kemal Sunal?

7. A e ka mbajtur veten dhe familjen larg nga media Kemal Sunal?

8. Sipas njerëzve si ka qenë ai në jetën e tij?

9. Kur ka vdekur Kemal Sunal?

10. Përse ka vdekur Kemal Sunal?

8.

Tregoni me disa fjali se kush është aktori/aktorja që pëlqeni ju? Shkruani rreth biografisë e aktorit/aktorese të preferuar.



Aktori/Aktorja që pëlqej unë



KLASA HABABAM

Në klasën hababam janë një grup studentësh të llastuar dhe të paditur. Ata nuk kanë mundur të diplomohen nga dembelizmi. Dhe janë regjistruar në një shkollë private e cila quhet Gjimnazi Privat i Çamlëxhasë. Këta studentë shumëngjyrësh janë klasa më e keqe në shkollë. Studentët dembel e ulin nivelin e sistemit arsimor. Pagesat e kësaj shkolle i kanë paguar prindërit e tyre. Por ata prindërit i kanë larg nga shkolla. Në këtë shkollë është një shërbëtore e cila quhet Hafize. Por të gjithë studentët e klasës hababam asaj i thonë nënë Hafize sepse ajo sillet me ata sikur i ka fëmijët e vetë.

Drejtori i kësaj shkolle quhet Mahmut. Ky drejtor është njeri i mirë dhe i dashur. Ai mundohet t'i disiplinoi dhe përgatisë studentët për në jetë.

Analiza e tekstit

Lloji:

Vendi i ngjarjes:

Personazhet:

10.

A i dini kuptimet e këtyre shenjave të mëposhtme? Mësoni nga familja, mësuesja ose nga interneti dhe shkruani kuptimet e tyre në vendet bashë.



Audienca e përgjithshme

1. Kush mund t'i shikoi këto filma?



7 vjeç e sipër

2. Kush mund t'i shikoi këto filma?



Dhunë

3. Kush mund t'i shikoi këto filma?



13 vjeç e sipër

4. Kush mund t'i shikoi këto filma?



Shembull negativ

5. Kush mund t'i shikoi këto filma?

11. Dëgjoni me vëmendje. Përgjigjuni pyetjeve sipas dialogut që dëgjoni.



1. Ku do shkojnë Sara dhe Ademi?

2. Në cilin film do të shkojë Sara?

3. A e pranon Ademi ftesën e Sarës?

4. Në cilin film vendosën ata të shkojnë?

5. Cilat filma i pëlqejnë Ademit?

12. Dëgjoni përsëri dialogun dhe shënoni llojet e filmave që kalojnë në dialog.



Dramë

Fantashkencë

Biografi

Aventurë

Komedi


Aksion

13.

Vazhdoni sipas përgjigjeve që jepni dhe në fund gjeni filmat ose programet të cilët më së shumti ju pëlqejnë.



A ju pëlqejnë filmat apo programet e tjera?



14. Detyrat.



A series of horizontal blue lines for writing, arranged in pairs across the page. Each pair consists of a solid blue top line and a dashed blue bottom line, providing a guide for letter height and placement.

A large white rectangular area with a dashed orange border, containing numerous horizontal dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and cover the entire width of the page, leaving a small margin at the bottom.

A large white rectangular area with a dashed orange border, containing numerous horizontal dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and cover the entire width of the page, leaving a small margin at the bottom.

MËSIMI 3



**SPORTET DHE
AVENTURAT**

1. Mësoni llojet e sporteve dhe bashkoni me vizë fjalët dhe figurat e mëposhtme.



Shqip	Turqisht	Shqip	Turqisht
Alpinizmi		Noti	
Atletika		Patinazh	
Basketbolli		Peshëngritje	
Boks		Pingpongu	
Çiklizmi		Shahu	
Futbolli		Skii	
Hipizmi		Tenis	
Mundje		Volejbolli	
		Xhudo	

2. Shënoni llojet e sporteve që dëgjoni.



shahu

çiklizmi

tenis

futboll

Noti

patinazh

3. Lexoni me vëmendje dhe gjeni për cilin sport bëhet fjalë.



A: Unë po shkojë në kursin e _____.

B: Aaa! Si po kalon kursi?

A: Shumë mirë. Mua më pëlqen shumë _____. Në fillim fillojmë të mësojmë kërcimin pastaj këtë e praktikojmë në akull.

B: Sa interesante!

A: Ky është një sport shumë i bukur. Përse nuk vjen edhe ti me mua?


B: Unë? Mua nuk më pëlqejnë vendet të ftohta. Dhe ky sport është shumë i rrezikshëm. Ne mund të thyejmë krahun ose këmbën.

A: Mos u shqetëso. Çdo lloj sporti ka rreziqe. Por ne nuk jemi vetëm. Ne na shoqëron mësuesi i sportit.

B: Por prapë është i rrezikshëm.

A: Nuk është aq i rrezikshëm sepse ne në këmbë dhe në krah vëmë mbrojtëse.

B: Mirë! Unë do të vij në një mësim.



Unë dua të bëj një sport por nuk e di cilin sport të zgjedh. **Skia/Atletizmi/Çiklizmi** është sport i shtrenjtë dhe bëhet vetëm në dimër. Çiklizmi është sport i mirë por duhet të blej **top/raketë/biçikletë** për këtë sport. Mund të bëj **not/atletizëm**. Ky sport nuk kushton shumë dhe vetëm duhet të blej rroba të rehatshme. Këtë sport mund ta bëj në çdo vend.



Duhet të dimë:

Sportet ndahen sipas stinës. Për shembull në dimër bëhen sportet ski, patinazh, hokej mbi akull etj.

Në verë bëhen sportet si noti, çiklizmi, tenisi etj.

5. Lexoni tekstin dhe shkruani fjalët që nuk i dini. Gjeni kuptimet e fjalëve në fjalor.



Gjmnastika ime e mëngjesit

Unë jam 28 vjeçe dhe quhem Mimoza. Mua më pëlqen shumë natyra. Unë çdo mëngjes ngrihem, vishem dhe bëj shëtitje në parkun i cili është në mes të qytetit. Përveç shëtitjes unë atje bëj edhe gjmnastikën e mëngjesit. Për shembull rrugën deri te hyrja e parkut e ec me hapa të shpejta. Kur vij në park filloj të bëj ushtrime të gjmnastikës.

Në fillim bëj ushtrimet e kokës. Vë duart në mes të kokës dhe lëviz kokën para, prapa, majtas dhe djathtas. Më pas e rrotulloj kokën një herë majtas dhe një herë djathtas. Por ushtrimet e mia nuk mbarojnë me kaq. Unë bëj ushtrime edhe për trupin. E përkul trupin përpara e prapa, majtas e djathtas.

Unë bëj ushtrime të tjera edhe për këmbët, duart dhe gishtërinjtë. Këto ushtrime vazhdojnë rreth 20 minuta. Kur mbaroj ushtrimet unë kthehem në shtëpi.

Kur shkoj në shtëpi lahem dhe pastaj bëhem gati për në punë.

Mësoni fjalët e reja:

Natyrë:

Shëtitje:

Përkul:

Gati:

Gjmnastikë:

Ushtrim:

Lëvizje:

Shpejt:

Hapa:

Rrotulloj:



1. Çfarë i pëlqen Mimozës?

2. Çfarë bën Mimoza çdo mëngjes?

3. Ku shëtit Mimoza?

4. Si ec Mimoza deri te hyrja e parkut?

5. Çfarë bën Mimoza kur futet në park?

6. Në fillim cilin ushtrim bën Mimoza?

7. Si i bën ushtrimet e kokës Mimoza?

8. Çfarë ushtrime të tjera bën Mimoza?

9. Sa minuta i bën ushtrimet Mimoza?

10. Pas ushtrimeve çfarë bën Mimoza në shtëpi?

11. Çfarë bën Mimoza pas larjes?



Unë jam Ali Sami Yen. Kam lindur më 20 maj 1886. Unë jam i biri i Şemsettin Samlut. Unë në vitin 1905 krijova klubin e futbollit. Kështu që unë jam themeluesi i Klubit Sportiv Galatasaray. Unë isha trajneri i parë i ekipit të futbollit në vitet 1905-1908.

Unë quhem Nazmiye Muratli. Kam lindur në datën 13 qershor 1979 në Konya. E kam filluar sportin në vitin 2004. Në vitin 2008 në lojërat olimpike verore u bëra e katërta në peshëngritje. Në vitin 2010 në peshëngritje me 110 kilogram theva rekordin e Turqisë. Në vitin 2012 theva rekordin botëror.



Unë jam Sinan Samil Sam. Kam lindur më 24 qershor 1974. Në fillim kam qenë boksier amator. Kam fituar 9 herë kampionatin e Turqisë. Unë njihem me pseudonimin "Demi i demave".



Fillim	3 emra sporti	Një emër sporti dimëror	Vazhdo 1 kuti para	2 emra të stinëve	Çfarë përdoret për çiklizëm?
					Cili sport bëhet në akull?
1 sport me shumë lekë	Kthehu në fillim	1 sport pa lekë	Hidhe prapë zarin		2 emra sporti veror
Cili sport bëhet me frymë?			1 sporti që nuk ju pëlqen		Kthehu 3 kuti pas
Sporti që bëhet në mal?			Kthehu 1 kuti pas		Çfarë bëhet në mëngjes?
Kthehu 3 kuti pas			1 sport që ju pëlqen		4 emrat e stinëve
2 sporte të ngadalshme		Fund	Hidhe prapë zarin		Vazhdo 5 kuti para
Hidhe prapë zarin					2 sporte për fëmijë
2 sporte të shpejta	1 sport që lozet me top	Vazhdo 2 kuti para	Sporti i cili veshim patina	2 sporte që lozen me grupe	3 sporte për të rritur

11. Detyrat.



A series of horizontal blue lines for writing, spaced evenly down the page.

A large white rectangular area with a dashed red border, containing numerous horizontal blue dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and cover most of the page's width.

A blank sheet of white paper with horizontal blue dotted lines, framed by a red dashed border. The lines are evenly spaced and run across the width of the page, providing a guide for handwriting or typing. The red dashed border is consistent in thickness and style throughout the page.

MËSIMI 4



VIGANI DHE
SHKURTABIQI



Një natë në Stamboll

Nata ka mbuluar me krahët e vet Stambollin. Dritat e shtëpive të qytetit po shuhen njëra pas tjetrës. Në një dhomë, buzë një rrugice të ngushtë, dritat nuk shuhen akoma. Është dhoma e punës e një shqiptari të madh.

Nga dritarja e vogël, drita duket ende. Brenda në dhomë ndodhet rilindësi i madh. I rrethuar nga librat, është ulur në një kolltuk të vjetër dhe shkruan ... Nga kalldrëmi i rrugës së ngushtë vazhdon të kumbojë zhurma e hapave të zaptijeve.

Dinjitoz, i heshtur, i vrazhdë, i brengosur nga të therurat e gjunjëve, nga reumatizmi i pashërueshëm, ai vazhdon të shkruajë. Kohë pas kohe e lëshon penën mbi tryezë dhe diku i mbërthen sytë. Ai ëndërron dhe shkruan, shkruan dhe ëndërron.

Në ato ujëra të kristalta ai soditi Shqipërinë e lirë. Ai pa universitetin ku hynin e dilnin mijëra djem e vajza me libra nën sqetull. E tërë Shqipëria aty ishte. Një lot shkau si një rubin nga sytë e tij, çau përmes rrudhave të asaj fytyre, u rrokullis në ujërat e kulluara të liqenit, e një valëz uji e rrethoi atë lot. Ai buzëqeshi. Ndoshta pas kaq e kaq vitesh ishte e para buzëqeshje që zbukuronte fytyrën e tij. Një valëz u përplas lehtas në breg dhe me zhurmën e vet ndoshta përshëndeti rilindësin e madh.

U zgjua nga ëndrra, erdhi në vete, fërkoj sytë me duart e veta dhe duart iu qullën. Kishte qarë. Drita e zbehtë e llambës me vajguri vazhdonte të përpëlitej dhe hapat ritmike të rëndë të zaptijeve dëgjobeshin nga jashtë. Ngriti pakëz kokën, hodhi sytë rreth e rrotull dhe i mbërtheu me mallëngjim librat që e rrethonin nga katër anët. Ndoshta deshi t'u jepte lamtumirën e fundit. Mori përsëri penën, por pena për herë të parë nuk iu bind dhe i shkau nga dora. E uli kokën mbi libër, po sytë iu veshën, fytyra iu zbeh, mjekra iu drodh.

Pena pret një dorë që të lëvizë, por dora s'lëvizë më. Dhe boja u tha mbi libër. Vdiq mbi libra, i rrethuar nga libra, si trim në fushën e betejës me armë në dorë.

Nonda BULKA

2. Bisedoni rreth tekstit të mëposhtëm.



Shkrimtari Nonda Bulka, nëpërmjet këtij teksti, na jep portretin e dijetarit dhe rilindësit të madh shqiptar Sami Frashëri. Në Turqi shkrimtari Sami Frashëri njihet me emrin Shemsedin Sami (Şemseddin Sami). Samiu ishte vëllai i vogël i personaliteteve të tjera të mëdha të Rilindjes kombëtare shqiptare Naim Frashërit dhe Abdyl Frashërit. Me këtë rrefim ai pasqyron çastin e fundit të jetës së dijetarit të madh shqiptar.

Pyetjet:

1. Si e përshkruan shkrimtari figurën e Sami Frashërit
2. Ku e shpie ëndrra Samiun?
3. Si e pa ai Shqipërinë në atë ëndërr?
4. Çfarë ndodhi pas ëndrrës që ai e pa?

3. Shkruani një tekst me titull "Një ditë në Stamboll".



Blank lined writing area for the student's response.

4. Dalloni "mbiemrin".

libër

Rruga e ngushtë.
Dritarja e vogël.
Rilindësi i madh.
Kolltuk i vjetër.
Njeri i heshtur.



Duhet të dimë:

Fjalët që tregojnë se si janë: *rruga, dritarja, rilindësi, kolltuku, njeriu* etj. quhen **mbiemra**.

5. Nënvizoni mbiemrat që gjendet në tekstin "Një natë në Stamboll".



6. Dalloni "gjininë e mbiemrit".

libër



Duhet të dimë:

Mbiemri i përshtatet mbiemrit për sa i përket gjinisë, merr gjininë e emrit pas të cilit shikon, si:

emri M. + mbiemri M.

trotuari + i ngushtë

djali + bujar

emri F. + mbiemri F.

rruga + e ngushtë

vajza + bujare

7. Shikoni me vëmendje figurat në këto dy foto dhe në vend të pikave vendosni emrin e duhur (vajza, djali, lisi, natyra, lulja, krimbi).



_____ sportiv.
_____ i glatë.
_____ i vogël.



_____ e zellshme.
_____ e bukur.
_____ shumëngjyrëshe.

8. Shkruani nga një "mbiemër" për secilin "emër".



Stambolli _____
uji _____
libri _____

shtëpia _____
drita _____
mjekra _____

9. Mësoni disa fjalë të urta shqipe.



Fjalë pak e punë shumë.

Fol pak e dëgjo shumë.

Njeriu i pamësuar si druri i papunuar.

Shqiponja fluturon në qiell, po folenë e

bën në tokë.

S'tundet mali nga dëbora.

Lumi fle, armiku s'fle.

Një krimb thanë një lis.

Ai që përton sot, do pendohet në mot.

Liria vjen kur s'i druhash vdekjes.

Trim i mirë me shokë shumë.

Populli

Pyetje:

1. Cilat mesazhe të fjalëve të urta të pëlqejnë më shumë? Trego arsyen.
2. Çfarë fjalësh të urta di në gjuhën turke që janë të ngjashme me këto që i përmendëm më sipër?



Vendi im i shtrenjtë

I bardhë është vendi im,
i bardh,
e lumenjtë të shpejtë,
të argjendtë.
I kaltër është qielli im,
i kaltër,
e lumenjtë të shpejtë,
të argjendtë.
I thellë është deti im,
i thellë,
e lumenjtë të shpejtë,
të argjendtë.
Hirplotë është vendi im,
hirplotë,
vendi im i shtrenjtë
me qiell të kaltër
e liqe të kthjelltë!

Hivzi Sulejmani

11. Lidhni me shigjetë emrat me mbiemrat.

Vendi	hirplotë
Lumi	i argjendtë
Deti	i kaltër
Qielli	i shtrenjtë
	i thellë
	i bardh
	i shpejtë

12. Shkruani mbiemrat me të cilat poeti i drejtohet atdheut.

13. Plotësoni ushtrimin sipas shembullit të dhënë.

Kjo është një **ntore e madhe** për klasën tonë.

Kjo është një **ntore e vogël** për klasën tonë.

Sa oborr i madh që qenka!

Sa oborr _____ që qenka!

Është i lagur nga shiu dhe më u duk shumë i vogël.

Është i lagur nga shiu dhe më u duk shumë _____.

Dëshira ime për të lexuar libra është e madhe.

Dëshira ime për të lexuar libra është _____.

Idetë e vogla janë për njerëz të vegjël.

Idetë e _____ janë për njerëz të _____.

14. Bëni dallimin në mes të dy mbiemrave.

libër

i vogël / e vogël
të vegjël / të vogla
Djalë i vogël. Vajzë **e vogël**.
Djem të vegjël. Vajza **të vogla**.

i madh / e madhe
të mëdhenj / të mëdha
Djalë i madh. Vajzë **e madhe**.
Djem të mëdhenj. Vajza **të mëdha**.

Duhet të dimë: Mbiemri përmban kategorinë e shkallës, kjo kategori shpreh masën ku shfaqet një cilësi e caktuar të sendit i dhënë. Mbiemri njihet tri shkallë: pohorja, krahasorja dhe sipërorja.

1. **Shkalla pohore** e mbiemrit emërton tiparin e sendit jashtë çdo krahasimi, p.sh.: **Mirëmëngjesi, ditë e re!**
2. **Shkalla krahasore** e mbiemrit tregon cilësinë e dhënë që krahasohet me vetveten apo një cilësi tjetër, p.sh.: **Ajo tregoi një histori sa të ndërlikuar aq edhe të papëlqyer.**
Petriti është më i gjatë se Arbeni.
3. **Shkalla sipërore** tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë shumë të lartë dhe jashtë çdo krahasimi, p.sh.: **Uji është jashtëzakonisht i ftohtë.**



15. Fjalitë e dhëna në pohore ktheji në shkallën krahasore të mbiemrit.



Mbrëmë kam parë një ëndërr të bukur dhe të gjatë.

Mimoza ka një libër me enciklopedi të pasur.

Gjyshja ime është një plakë e zgjuar dhe e buzëqeshur.

16.

Gjeni shkallën e mbiemrit të fjalitë e dhëna. Me ngjyrë të kuqe nënvizoni fjalitë në shkallën pohore, me blu ato krahasore si dhe me të verdhë ato "sipërore".



Vendi im i shtrenjtë. Vendi im më i shtrenjtë se vendi i huaj. Vendi im është shumë i shtrenjtë.
 Deti i thellë. Deti është më i thellë se sa liqeni. Deti është tepër i thellë.
 Liqeni i kthjelltë. Liqeni i kthjelltë po aq sa deti. Liqeni është jashtëzakonisht i kthjelltë.

17.

Lexoni tekstin. Më pas bisedoni rreth vetes tuaj.



Unë kam dy vëllezër më të mëdhenj dhe një motër më të vogël. Motra ime e vogël quhet Arbëresha. Sytë e saj janë të mprehtë si sy shqiponje. Goja e saj është e vogël por si një inxhi. Flokët e saj janë të zinj dhe si mëndafsh. Nëna i blen asaj çdoherë nga një kapelë të bukur. Por, koka e saj është aq e vogël sa që çdoherë kapela që vë në kokë i vjen e madhe. Prandaj, të gjithë në shtëpi atë e thërrasin "princesha kapelmadhe".

18.

Lojë.



Së bashku me mësuesin / mësuesen me anë të lojës së titulluar "Vigani dhe shkurtabiqi" bëni përsëritjen e mbiemrave të mësuar. Me anë të kësaj loje bëni formimin e fjalive në cilën do të përfshihni mbiemrin i cili do t'i përshtatet emrit sipas numrit dhe gjinisë, duke mos harruar edhe shkallën.

19. Detyrat.



A series of horizontal blue lines for writing, arranged in a grid pattern across the page.

A series of horizontal dotted lines for writing, spanning the width of the page.

A blank sheet of white paper with horizontal blue dashed lines, framed by a dashed border. The lines are evenly spaced and cover the entire page.

MĚSIMI 5



TURIZĚM

1. Të mesojmë llojet e turizmit.



Turizëm kulturor



Turizëm bregdetar



Turizëm nautik



Turizëm dimëror



Turizëm shëndetësor



Turizëm aventurë



Turizëm fetar



Turizëm rural

2. Mundohuni t'i bashkoni llojet e turizmit me sgarimet e mëposhtme.

- | | | | | | |
|------------------------|--------------------------|----------------------|--------------------------|---------------------|--------------------------|
| 1. Turizëm nautik | <input type="checkbox"/> | 2. Turizëm aventure | <input type="checkbox"/> | 3. Turizëm dimëror | <input type="checkbox"/> |
| 4. Turizëm rural | <input type="checkbox"/> | 5. Turizëm bregdetar | <input type="checkbox"/> | 6. Turizëm kulturor | <input type="checkbox"/> |
| 7. Turizëm shëndetësor | <input type="checkbox"/> | 8. Turizëm | <input type="checkbox"/> | 9. Turizëm fetar | <input type="checkbox"/> |

- Ky lloj turizmi është turizëm që ndodhet rreth bregdetit.
- Udhëtime në vende të ndryshme për të parë gjërat e rralla, veprat e mëdha, bukuritë e natyrës etj.
- Me këtë lloj turizmi mund të mësojmë kulturën e vendeve të tjera.
- Në këtë turizëm mund të shëtisim me barka, anije ose me jahte luksoze.
- Ky lloj turizmi bëhet në vende kodrinore si janë fshatrat e thella ose zonat malore.
- Ky lloj turizmi është turizëm që bëhet në dimër.
- Ky lloj turizmi përbëhet prej shërbimeve shëndetësore në zonat turistike.
- Ky lloj turizmi përbëhet nga disa lloj sporte.
- Në këtë lloj turizmi njerëzit udhëtojnë individualisht ose në grupe për pelegrinazh.

3. Lexoni tekstin dhe përgjigjuni pyetjeve sipas tekstit të mëposhtëm.

Një udhëtim në Paris

Unë quhem Blerta. Unë shkova në Francë verën e kaluar. Fluturimi me aeroplan ishte i lodhshëm dhe bileta ishte e shtrenjtë. Udhëtimi nga aeroporti i Tiranës deri te aeroporti i Parisit zgjati pesë orë. Kur mbërrita në aeroport shoqja ime Klara po më priste në dalje të aeroportit. Pasi u takova me atë dhe hipëm në një taksì dhe shkua në qendër të qytetit. Qendra e qytetit ishte shumë e bukur dhe e madhe. Gjatë shëtitjes në Paris unë mësova shumë për kulturën e këtij qyteti. Mësova shumë gjëra edhe për jetesën e njerëzve. Ky ishte një turizëm kulturor për mua.

- Nga u nis Blerta për në Paris?

- Me çfarë udhëtojë Blerta?

- Sa orë zgjati udhëtimi?

- Me kë u takua Blerta?

- Ku po e priste shoqja Blertën?

- Ku shkuan Blerta dhe Klara?

- Si ishte qendra e qytetit?

- Çfarë ka mësuar Blerta gjatë shëtitjes në Paris?

- Çfarë lloj turizmi ishte udhëtimi i Blertës në Paris?

- Çfarë dini ju për Parisin?

4.

Mundohuni t'i gjeni shtetet dhe qytetet e fotografive të dhëna. Nëse nuk i dini atëherë pyesni familjen/mësuesin/mësuesen ose i kërkoni në internet.



Shtet:
Qytet:



Shtet:
Qytet:



Shtet:
Qytet:



Shtet:
Qytet:



Shtet:
Qytet:



Shtet:
Qytet:

5.

Përgjigjuni pyetjeve me disa fjali. Në fillim i shkruani në fletore dhe më pas i lexoni me zë në klasë.



1. Çfarë mendoni për vendet turistike?

2. Çfarë lloj turizmi ju pëlqen më shumë dhe përse?

3. Numëro disa vende turistike të tjera në botë.

4. Trego vendet turistike në shtetin që jeton ti.

5. Nëse do krijote një vend turistik si do të doje të dukej ai?

6.

Dëgjoni dialogun e mëposhtëm dhe mundohuni të gjeni se për çfarë lloj turizmi po bisedojnë ata.



Dardan: Mirëdita Nora. A je gati?

Nora: Mirëdita Dardan. Unë gati jam dhe jam shumë e emocionuar.

Dardan: Përse je kaq e emocionuar?

Nora: Sepse unë për herë të parë do hipi në anije.

Dardan: Po për vendet që do shkojmë çfarë mendon?

Nora: Ne do shkojmë në pesë vende të ndryshme të botës me anije. Sigurisht kjo është një gjë shumë e bukur.

Dardan: Unë mendoj se ky lloj turizmi është më i bukur se sa të tjerët.

Nora: Edhe mua po më pëlqen shumë turizmi Dardan.

Dardan: Eja! Shkojmë!

Turizëm

7.

Krijoni edhe ju një dialog me shokun/shoqen në lidhje me turizmin ose me një vend turistik.



Ti: _____

Shoku/shoqja : _____

Ti: _____

Shoku/shoqja : _____

Ti: _____

Shoku/shoqja : _____

Ti: _____

Shoku/shoqja : _____

Ti: _____

Shoku/shoqja : _____



Emri:	Kalaja e Rozafës
Vendi:	Shkodra
Data e ndërtimit:	1468
Përse është e njohur:	Kështjellë e rëndësishme, legjenda

Përsëndetje të gjithëve!

Unë sot do ju tregoj për historinë e Kalasë së Rozafës.

Kalaja e Rozafës ndodhet në një kodër të qytetit të Shkodrës. Rreth kalasë janë lumenjtë Drin dhe Buna. Shkodra është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë. Në këtë kala janë zhvilluar disa luftëra. Qyteti dhe kalaja janë një qendër e rëndësishme kulturore dhe ekonomike. Çdo vit vijnë shumë turistë për ta vizituar. Përveç të dhenave dhe vlerave historike Kalaja e Rozafës njihet edhe me një legjendë. Kjo legjendë është e bukur por edhe e hidhur.

Kala:	Luftë:
Kodër:	Legjendë:
Lumë:	E hidhur:

10. Të bëhemi grupe dhe të lozim lojën. Loja lozet me një zar.



Fillim	A ke qenë ndonjëherë jashtë shtetit?	Përshkruaj udhëtimin tënd më të mirë.	Me çfarë udhëtoni?
			Pushimet e dimrit apo pushimet e verës?
A ke udhëtuar me tren ndonjëherë?	A ke fluturuar me aeroplan ndonjëherë?	Çfarë lloj turizmi preferon?	Vendi që të pëlqen më shumë?
Vendi i preferuar brenda shtetit.			
A është turizmi i rëndësishëm?	Ku i kalove pushimet e fundit?	Pushimet jashtë shtetit apo brenda shtetit?	Trego udhëtimin më të keq.
			A ke bërë kamp ndonjëherë?
Fund	Cilat vende të Shqipërisë dini?	A ke udhëtuar me anije ndonjëherë?	A të pëlqen të jesh turist/e?

11. Detyrat



A series of horizontal blue lines for writing, spanning the width of the page.

A large white rectangular area with a dashed orange border, containing numerous horizontal blue dotted lines for writing.

MĚSIMI 6



NATYRA

1. Lexoni tekstin, kuptoni dhe gjeni nga fjalori fjalët që nuk i dini.

libë

Në natyrën e gjallë ne kemi bimët, kafshët dhe njerëzit. Të gjitha këto kanë karakteristika të përbashkëta. Të gjitha ushqehen, rriten, zhvillohen, shumohen dhe vdesin. Prandaj ne këto i quajmë qenie të gjalla dhe këto janë pjesa e natyrës së gjallë. Të gjitha këto kanë nevojë për kushte të caktuara për të jetuar. Për shembull; kanë nevojë për ujë, ajër, tokë, diell. Dornethënë, çdo gjë që ekziston në botë, por njeriu nuk e ka bërë, është natyrë: uji dhe toka, drurët dhe lulet, kafshët dhe shpendët, malet dhe luginat, ajri dhe shiu, por edhe vetë njeriu.

Natyrë:	E gjallë:
Të përbashkët:	Ushqehen:
Rriten:	Zhvillohen:
Shumohen:	Vdesin:
Qenie:	Nevojë:
Kushte:	Ajër:
E caktuar:	Tokë:
Diell:	Ekziston:
Dru:	Lule:
Shtazë:	Shpend:
Mal:	Luginë:
Shi:	Botë:



Duhet të dimë:

Çdo gjë që kemi rreth e rrotull quhet natyrë. Këto gjëra janë bimët, kafshët, njerëzit, uji, ajri, toka, Dielli etj.

Natyrë ndahet në dy: natyrë e gjallë dhe natyrë jo e gjallë.

Por në natyrë ka gjëra që i ka krijuar edhe njeriu.

2. Mësoni cilat gjëra janë në natyrë.



Ujëvarë



Liqen



Mal



Lumë



Pyll



Ishull



Plazh



Shkretëtirë



Oqean



Kodër

3. Tregoni cilat nga vendet të natyrës i dini ose i keni vizituar.

4. Në botë ndodhin fatkeqësia natyrore. Mësoni cilat janë ato dhe mundohuni t'i bashkoni fjalët me figurat e dhëna.



a. Tërmet	b. Shpërthim vullkanik	e. Shkretëtirë	d. Stuhi
e. Përmytje	f. Cunami	g. Krëshqitje	h. Ortek

5. Gjeni fjalët e duhura të cilat duhet të vijë në vendet boshe.



përmbytje, ortek, stuhi, tërmet, cunami, shkretëtirë, shpërthim vullkanik

1. Në qytetin tonë pallatet bëhen shumë të forta sepse shpesh herë bëhet _____
2. Në lajme dëgjova se ka ndodhur një _____ në Meksikë dhe çdo vend është mbushur me tym dhe me hir.
3. Unë kam shumë frik kur bëhet _____ prandaj në kohë të keqe nuk dal përjashta.
4. Saharaja është _____ e dytë më e madhe në botë.
5. Ka ndodhur një _____ i papritur në alpet austriake.
6. Qindra njerëz u përfshinë papritur nga një _____ në Japoni në vitin 2011.
7. Sipas lajmeve këtë javë do të bjeri shumë shi dhe pritet të ndodhin _____ të mëdha.

6. Dëgjoni me vëmendje dhe vini fjalët e duhura në vendet boshe.



Shumica e njerëzve nuk mund të qëndrojnë në _____ e egër pa pajisjet e nevojshme. Ndërsa Ed Stafford merr vetëm _____ e tij dhe kalon javë në një ishull ose në një _____ pa ushqim ose ujë. Ai e ka ecur _____ e Amazonit vetëm dhe për këtë arsye ka marrë një rekord në Guinness. Ai udhëton për të zbuluar gjëra të reja në _____. Ed Stafford dëshiron të tregojë se njerëzit mund të jetojnë në natyrë dhe nuk kanë nevojë për asgjë. Ekipi i tij e lë atë në një _____ që ai dëshiron dhe pastaj fillon _____ e tij. Ai është shumë i talentuar. Për shembull ai mund të ndezi zjarr pa shkrepsë ose çakmak. Ai mund të kapi _____ me duart e tij. Por më e rëndësishmja nga këto është se ai mund të jetojë duke ngrënë çdo gjë në natyrë të _____.

A mund të jetëni edhe ju si Ed Stafford në natyrë të egër? Përse jo? Përse po?

7. Lexoni dhe kuptoni tekstin.

Zgjimi i Ariut

Një çudi e padëgjuar ndodhi këto dite në pyll. Një arlu i doli gjumi i dimrit para se të vinte pranvera! Ariu u afrua në anë të shpellës dhe shikoi një here jashtë. Atje ishte ende fresket. Disa gëmusha ruanin ndonjë grusht bore, që kishte mbetur pa shkrirë. Para shpellës fluturoi papritmas një harabel. Ariu, porsa e pa, e thirri:

- Harabel, ndalo! Dua të pyes për diçka. Nuk e di se si më doli gjumi pa ardhur pranvera e vërtetë. Të lutem, më thuaj a është shkrirë akulli në përrua? A mund të zë të pakten ndonjë peshk?

- Nuk është shkrirë i tërë akulli, por ti mund ta thyesh me turë. Turiri yt është i fortë, - tha harabeli me gëzim.

- O, jo, jo..., - tha ariu, - më mpihen dhëmbët edhe nga akulli. Më mirë të mos zbres në përrua... Po, harabel i dashur, shiko pak më larg, andej nga lisi njëqindvjeçar... Në trungun e tij banojnë me mijëra bletë. A thua, e kanë hapur derën e tyre? A mund të marrë mjaltë? Harabeli fluturoi lart dhe u kthye mbi gëmushë.

- Jo, o ari. As bletët nuk e paskan hapur ende derën, por s'ka gjë. Turiri yt mund të thyejë shumë gjëra... Eh, ta kisha unë sqepin tim të vogël si turirin tënd!... - tha harabeli me lakmi.

- Uh, uhi!... - tha përsëri ariu. - Po në qoftë se më sulmojnë bletët? Ç'të bëj atëherë në këtë të ftohtë?! Jo, o harabel, jo, nuk guxoj të shes trimëri, ashtu si thua ti. Por, të lutem, shiko andej nga fusha. A mos ka lulëzuar qershia?

- Unë prej andej vij, o ari, - i tha harabeli. - Nuk gjeta asgjë për vete. Prandaj erdha këndeje të kërkoj diçka. Eja me mua, nuk do të vdesësh nga uria. Arallëherë gjej ndonjë ushqim, por më pëlqen kjo natyrë. Është shumë e bukur dhe e dashur...

- He, he, he! ... tha përsëri ariu dhe shtoi: - Mua nuk më pëlqen natyra. Më pëlqen vetëm të ha e të fle dhe asgjë tjetër. Do të provoj të fle edhe ndonjë ditë, ndoshta më merr gjumi përsëri në shpellën time të ngrohtë.

- Hyr, o përtaci! - i tha harabeli dhe fluturoi shpejt për të shikuar çdo gëmushë e çdo lis që bëhej gati të zgjohej bashkë me pranverën...

Qamil Batalli

8. Mësoni fjalët që nuk i dini në tekst.



Çudi:	Padëgjuar:	Shpellë:	Turt:
Mpirje:	Sulm:	Fushë:	Qershi:
Uri:	Përtac:	Lis:	Trung:
Bletë:	Mjaltë:	Sqep:	Ende:
Gëmushë:	E shkrirë:	Harabel:	Përrua:

9. Përgjiguni sipas tekstit të mësipërm "Zgjimi i ariut".



1. Ku ndodhi një çudi e padëgjuar?

2. Si ishte koha kur u zgjua ariu?

3. Me kë fliste ariu?

4. A është thyer akulli?

5. Ku banojnë bletët?

6. A i pëlqen ariut natyra?

7. Çfarë i pëlqen ariut?

8. Kujt i tha përtac harabeli?

9. Kush po zgjohej bashkë me pranverën?

10. Tregoni me një fjali. A ju pëlqeu ky tregim?

10. Mësoni si ndërtohet një tregim.

Në **hyrje** të tregimit duhet të jenë **personazhet, koha dhe vendi** ku ndodh ngjarja.

HYRJA

Në pjesën e **zhvillimit** të tregimit tregohet se çfarë ndodh. Kjo është pjesa më e gjatë e tregimit. Sepse ka shumë dialogë, përshkrime dhe tregohen sjelljet dhe veprimet e personazheve.

ZHVILLIMI

Në **mbyllje** të tregimit tregohet se si përfundon ose mbaron ngjarja.

MBYLLJA

11. Analizoni ndërtimin e tregimit "Zgjimi i ariut" së bashku me shokët/shoqet në klasë.

12. Detyrat.



A series of horizontal blue lines for writing, arranged in a grid pattern across the page. Each line is accompanied by a dotted line below it, providing a guide for letter height and placement. The lines are evenly spaced and cover most of the page area.

A blank sheet of white paper with a dashed black border. The page is filled with horizontal blue lines, spaced evenly down the length of the page. There are 25 lines in total, providing a guide for handwriting or typing.

A large white rectangular area with a dashed black border, containing numerous horizontal dotted lines for writing.

A large white rectangular area with a dashed black border, containing numerous horizontal blue dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and cover most of the page's width and height.

MËSIMI 7



PUNËT E SHITËPISË

1. Dëgjoni dhe lexoni tekstin.



Kush di të rregullojë?

Në mbrëmje Era dhe Tiku ishin vetëm në shtëpi. Ata donin t'i kënaqnin prindërit, kur të ktheheshin në shtëpi. Prandaj filluan të pastrojnë.

Era hodhi llaçin e enëve në ujë. Ujë u mbush plot me shpumë. Era kishte shumë qejf të lante pjatat me tërë atë shpumë sapuni. Tiku prishte t'i vinte radha për të fshirë pjatat. Era, pasi i shkumoi ato, bëri çezmen dhe filloi t'i shpërlante. Kur mbaruan, vunë re se uji rridhte poshtë tubit të lavamanit.

- Si do të bëjme? - tha Era e shqetësuar.

- Do të lajmëroj unë xhaxhi Sabriun.

Xhaxhai i tyre është hidraulik. Ai erdhi shumë shpejt dhe nxori vegjat nga çanta. Kishte një tel sustë që e përdori për të pastruar vrimen e lavamanit. Me çelësin papagall ai shtrengoi tubin e lavamanit. Kur mbaroi, fëmijet e falënderuan me gjithë zemër.

RITA PETRO

2. Bisedoni duke u përgjigjur pyetjeve.



1. Me çfarë po merreshin Era dhe Tiku në shtëpi?

2. Si i kishin ndarë punët ata?

3. Çfarë vunë re ata?

4. Kë e thirrën për ndihmë?



3. Shkruani se cilët janë punët që i bëni në shtëpi.



5. Të shkruajmë se cilat punë në shtëpinë tuaj i bën babai e cilat i bënë nëna.

Babi
-fshin xhamat.
-shtrin rrobat në tel.

Nëna
-rregullon rubinetin.
-vë fshesën me korrent

6. Bisedoni në klasë se si e kaloni një ditë së bashku në shtëpi me familje.

7. Shkruani një ese me temën "Në shtëpinë tonë secili ka obligimet e veta" pasta j lexoni në klasë dhe zgjidhni më të bukurën.



8. Mësoni mënyrën urdhërore.

Mëso më shumë!
Puno nëse do të fitosh!
Fli se u bë vonë!
Shkoni më shpejtë se po ju presin!
Ejani se ngelëm këtu!



Duhet të dimë: Me anë të kësaj mënyre shprehet modaliteti i dëshirës në formë urdhri, kërkesë, këshillë, porositje, lutje, lejimi etj. Ja disa shembuj: mëso, puno, shko, mat, fshi, jë, ki, fli etj.

Ti **shko**

Ju **shko-ni**

Ti **merr**

Ju **merr-ni**

Ti **pi**

Ju **pi-ni**



Duhet të dimë: Kjo mënyrë ka vetëm vetën e dytë njëjës dhe shumës. Në vetën e dytë shumës të gjitha foljet dalin me të njëjtën formë si në vetën e dytë shumës të dëftores. Këto dy forma homonime dallohen në mes vete vetëm me anë të intonacioni, si: *Këndoni. - Këndoni!, Ejani. - Ejani!, Dini. - Dini! ...*

U nis për Edirne, mos e prit!
 Mos e vrit mendjen për këto gjëra, ajo që është thënë do të bëhet!
 Po vjen drejtori mos e ngrit zërin!
 Më në fund erdhi dita e Jonë prandaj mos qaj po këndo!



Duhet të dimë: Në fjalitë me kuptim mohor para urdhërës vendoset pjesëza mos.

12. Dëgjo dhe meso vjershën "Nëna ime i lan rrobat me një gisht".



Nëna ime i lan rrobat me një gisht

Nëna ime
lan rrobat me një gisht.
Saora, saora
Dhe bardh, bardh
sikur bora.
Tik!
Me një gisht
prek sustën në makinë.
Dhe lan
i shpërlan
dhe i than.

VEHBI KIKAJ

13. Bisedoni duke u përgjigjur pyetjeve.



1. Kush i lan rrobat me një gisht?
2. Si i lanë nëna rrobat?
3. Si duken rrobat që i lan nëna?
4. Po nëna jote si i lan rrobat?

17. Detyrat



A series of horizontal lines for writing, consisting of a solid top line, a dashed middle line, and a solid bottom line, repeated down the page.

A large white rectangular area with a dashed blue border, containing numerous horizontal dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and extend across the width of the page, providing a template for text entry.

MËSIMI 8



**HISTORI,
PËRRALLË E
TREGIME**

1. Dëgjoni dhe lexoni tekstin.



Nga pellazgët tek Ilirët

Territori ku sot banojnë shqiptarët ishte populluar nga pellazgët, një popullsi që banonte në pjesën më të madhe të Ballkanit. Ata flisnin pellazgjisht. Pasardhësit e pellazgëve janë Ilirët. Ilirët janë paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve. Në pjesën perëndimore të Ballkanit shtrihet Iliria, në veri që nga lumi Sava dhe në jug gjer në gjirin e Ambrakisë.

Ilirët jetonin të ndarë në fise. Fiset kryesore Ilire ishin: taulantët, enkejdët, albanët, ardlanët, dalmatët, dardanët, molosët, kaonët etj.

2. Bisedoni duke u përgjigjur pyetjeve.



1. Cilët janë paraardhësit e drejtpërdrejtë të shqiptarëve?
2. Ku shtriheshin Ilirët?
3. Përmend fiset kryesore të Ilirëve?

3. Mësoni pak lidhur me kulturën dhe artin ilir.

Kultura dhe arti ilir

Ilirët ishin popull me kulturë të pasur. Arti i tyre ishte i përqendruar në zbukurimin e objekteve, në veçanti të enëve prej balte. Në qytet e Ilirisë ndërtoheshin teatro dhe stadiume. Përpos që pëlqenin teatrin e sportin ata po ashtu zhvilluan edhe letërsinë dhe skulpturën.



Duhet të dimë:

- Ilirët flisnin gjuhën ilire prej nga e ka prejardhjen edhe gjuha shqipe.
- Ilirët kishin një kulturë të veçantë prej popujve tjerë fqinjë.
- Ilirët merreshin me letërsi, sport, teatër, muzikë, kërcim si dhe skulpturë.
- Ilirët kishin zhvilluar arkitekturën, aty hyn ndërtimi i banesave, stadiumeve dhe teatrove.

4. Dalloni dhe mësoni lidhëzat.

Në qytetin tim janë ndërtuar teatro **dhe** stadiume. Djemtë e vajzat e klasës shkojnë t'i vizitojnë këtë të diel. **Mirëpo**, unë jam i sëmurë dhe nuk besoj se do të mund të shkoj.

Fjalët **dhe**, **e**, **mirëpo** janë lidhëza.

Lidhëzat lidhin dy fjalë:

-Anita **dhe** Teuta janë motra.

Lidhëzat lidhin dy gjymtyrë fjalie:

Mbrëmë fjeti vonë **prandaj** u vona për në mësim.



Duhet të dimë: Lidhëzat janë fjalë të pandryshueshme dhe shërbejnë për të lidhur dy ose më shumë gjymtyrë fjalie apo dy a më shumë pjesë fjalie.

5. Dalloni lidhëzat bashkërenditëse dhe nënrenditëse dhe rolin e tyre në fjali.

Llojet e lidhëzave

- Lidhëzat që lidhin dy fjalië apo dy pjesë fjallie, të cilat janë në marrëdhënie barazie me njëra-tjetrën quhen **lidhëza bashkërenditëse**. Ato janë: e, dhe, edhe, as, a, apo, po (por), mirëpo, kurse, prandaj etj. Gjyshit i pëlqen të lexojë gazetë **apo** roman?

Genti do të shkojë në Tiranë **kurse** unë me Erën në Prishtinë.

- Lidhëzat që lidhin fjali me raporte varësie quhen **lidhëza nënrenditëse**. Ato janë: që, se, sepse, pse, si, posi, sapo, sikur, sikurse, megjithatë etj.

Agroni u ndal **sapo** e pa mësuesin në korridor.

Albulena do të bëhet shkrimtare **sepse** shkruan bukur.

Lidhëzat mund të jenë:

- të thjeshta: e, dhe, ku, kur, që, se etj.

- të përngjitura: mirëpo, kurse, përse, posi etj.

- dhe shprehje: në qoftë se, sado që, kështu që etj.

Mbreti i kafshëve luani kërkonte **që** çdo ditë të hante një dash dhe një gomar. Ujku **dhe** dhelpa lidhën besë **që** të bëjnë miqësi me luanin. Nëna e këshillonte çdo ditë **mirëpo** ai nuk ia varte veshin. **Në qoftë se** vjen tek unë për darkë do të gatuj byrek.

6. Plotësoni fjalitë me njërin nga lidhëzat: *kështu që, dhe, se, që, mirëpo, për arsye se.*



Në një ditë me diell Ardita _____ Besimi dolën të ecnin në park. Pas disa minutash filloi të bie shi.

_____ ata kishin harruar të merrnin çadrën. _____ binte shi, Besimi pyeti Arditen _____

ku dëshironte ajo që të shkonin në kinema _____ në teatër. Ajo lu përgjigj _____ asaj i

pëlqen më shumë filmi. _____ vendosën të shkojnë në kinema.

7. Ndani lidhëzat e mësipërme në tri grupe.



Lidhëza të thjeshta


Lidhëza të përngjitura

Lidhëza me shprehje

8.

Gjeni lidhëzat në fjalitë e mëposhtme dhe vendosni ato në fjalëkryq. Pastaj me lidhëzat e gjetura formoni një lidhëz tjetër.

Nuk erdha në ditëlindjen tënde për shkak se isha i sëmurë.
Sikur të ishe pak më i kujdesshëm do të ishte më mirë.
Nuk më hahet asgjë mirëpo do të provoj byrekun që ke gatuar.
Mos prit sepse do të vonohem pak.
Blerina dhe Ëurimi do të nisen me të gdhirë.



9.

Shkruani nga një fjali me lidhëzat e dhëna: *dhe, apo, pasi, mirëpo, ndonëse, sado që*.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

10.

Dëgjoni dhe mësoni vjershën "Shoku im".

Shoku im

Kam një shok,
të dy tok,
Shkojmë në orë pa mërzë,
më tregon,
më mëson,
shumë gjëra që s'i di.
e pushtoj,
plot gëzim e dashuri.

Fort e dua,
se për mua
është shok për mençuri.
Pa përtim, me durim,
shoku im më ndihmon,
dhe ky është ...
Kush e di?
Libri im që më mëson.

Bekim GAÇE

11. Bisedoni për vjershën "Shoku im".



1. Cili është shoku më i mirë që ka djali / vajza?
2. Çfarë bën djali / vajza së bashku me librin?
3. Çka i tregon libri atij / asaj?

12. Bisedoni së bashku rreth "librave".



1. Cili është shoku yt më i mirë?
2. Për ty sa është i rëndësishëm libri?
3. A ke libra në gjuhën shqipe dhe cilat janë ato?
4. A të kanë bërë dhuratë shokët / shoqet ndonjë libër?

13. Shkruaj listën e librave që ke lexuar, pastaj zgjedh një shok / shoqe dhe krahasoni listat duke gjetur se sa libra të përbashkët i kenë lexuar.



14. Bëni një aktivitet së bashku.



Secili prej jush le ta paraqesë me anë të vizatimit librin më të preferuar të tij. Në fund mësuesi / mësuesja le t'i mbledh vizatimet e bëra duke i bashkuar ato. Kjo përmbledhje punimesh le të emërtohet si "Libri i klasës sonë".

15. Të njohim gjuhën tonë. Lexoni tekstet e mëposhtme.

Në shtëpinë tonë të gjithë lexonin: nëna, babi dhe gjyshi me gjyshen. I vëreja fytyrat e tyre të përkulura mbi libra. Ata herë buzëqeshnin, herë trishtoheshin, herë kthenin me ngut faqen. Dukej sikur udhëtonin në vende të mrekullueshme. Unë habitesha shumë. Doja të dija çfarë po ndodhte me ta, kur lexonin. Pse nuk më merrnin edhe mua me vete? Çfarë kishte aty brenda në libër? Më vonë mësova të lexoj. E mësova sekretin e librave.

E.J.

Kur një mëngjes

Do të jetë mëngjes e unë do të vij patjetër.
Mbi xhakëtën time do të kenë rënë petale.
Nga lulet e kumbullës së vjetër,
Nga lulet e thanës së tharët.

Dritëro Agolli

3 lapsa
1 gomë
3 fletore me vija
7 fletore me katrore
2 vizore
1 kuti lapsa me ngjyra

Rosaku i shëmtuar

Rosa mëmë nxori jashtë për herë të parë bibat e saj, ajo vërejti se njëra prej tyre ishte ndryshe. Rosa deshë ta largonte nga çerdhja e saj por përsëri ndërroi mendje se i erdhi keq. Ditët kalonin dhe rosaku për shkak se ishte i shëmtuar asnjë nga vëllezërit dhe motrat e tij nuk pranonin të luanin me të. Rosaku e ndjente vetën shumë fatkeq. Gjithmonë e pyeste vetën pse ishte ndryshe nga rosakët e tjerë. Kaluan ditë, javë e muaj. Një ditë rosaku del nga foleja për në liqen. Në ujlin e liqenit si pasqyrë dhe aty pa që ai ishte shndërruar në një mjellmë të re dhe të bukur.

Hans Kristian Andersen

Edona Bala "Në magjinë e teatrit të kukullave"

Teatri i kukullave i ka paraprirë filmave të animuar që kanë po ashtu të njëjtin qëllim dhe funksion si ai. Më ka lënë mbresa i gjithë historiku i tij dhe mënyra sesi kukullat krijoheshin nga artistët dhe se si viheshin në skenë në mënyra të ndryshme nga aktoret. Punoheshin me shumë dashuri nga piktorë që nuk ishin aq të njohur për njerëzit dhe viheshin në skenë nga aktorë, të cilët nuk e shfaqnin fytyrën e tyre të fëmijët. Bukuria e këtij arti qëndron edhe te misteri që përmban në vetvete për fëmijën edhe te fakti që arrin të përçojë mesazhe të rëndësishme sociale dhe të edukojë përmes zbavitjes.

16. Njohim tekste të ndryshme.

Gjeni se cilat prej teksteve të lartpërmendura janë: vjershë, tregim, përrallë, shkrim në gazetë dhe listë. Vendosni numrat në rrathët bosh të ushtrimit të mësipërm.

1. Tregim

2. Përrallë

3. Vjershë

4. Listë

5. Shkrim në gazetë

17. Lidhni me shigjetë anën e majtë me të djathtën.

Nxënësi bën
Poeti shkruan
Çjyshja tregon
Shkrimtari shkruan
Gazetari bën

vjershë për atdhedashurinë.
listën e nevojave të shkollës.
shkrime në gazetë.
përralla të bukura.
tregime për fëmijë.

18. Shkruani përgjigjet e pyetjeve.

1. Pse kemi dëshirë të dëgjojmë përralla?

2. Pse i mësojmë vjershat përmendësh?

3. A na ndihmon lista për të mos harruar ndonjë gjë?

4. A ke menduar ndonjëherë të bëhesh shkrimtar? Pse?

5. A lexon revista për fëmijë? Cila të pëlqen?

19. Detyrat.



A series of horizontal lines for writing, consisting of a solid top line, a dashed midline, and a solid bottom line, repeated down the page.

A large white rectangular area with a dashed green border, containing numerous horizontal dotted lines for writing. The lines are evenly spaced and extend across the width of the page, providing a template for handwriting practice.

MËSIMI 9



ËNDRRA IME

1. Dëgjoni dhe mësoni vjershën "Jastëku i ëndrrave".



Secili ka një jastëk të tij,
ka gjithjsha ime e mirë,
nëna, babai e motra Dritë,
dhe unë kam një të tillë.

Më i mirë është jastëku im,
është i butë, i pastër shumë,
në livadhe ëndrrash me gëzim
më shëfit mua kur bie në gjumë.

Ëndrra të tjera ka jastëku i mamit,
ëndrra të tjera ka jastëku i babait,
ëndrra të tjera ka jastëku i mikut ...
Mua më pëlqejnë ëndrrat e mia
dhe për to dua të shkruaj.

Vehbi Kikaj

2. Bisedoni dhe diskutoni rreth vjershës në klasë.



1. Autori me çfarë e lidh jastëkun me gjumin, me familjen, me shokët, me ëndrrat, me ditën apo me natën?
2. Cilat mund të jenë ëndrrat e jastëkut të mamit?
3. Po ëndrrat e jastëkut të babait cilat mund të jenë?
4. A të ka treguar ndonjë ëndërr miku yt?
5. Tregoju shokëve / shoqeve ëndrrën e fundit që ke parë.

3. Përshkruaje dhe komentoje ëndrrën më interesante që ke dëgjuar nga shokët / shoqet e klasës.



4. Bëni dallimin e ëndrrave symbyllur dhe ëndrrave syhapur.

a. Ëndërroj të kem:

Një libër me vendet më interesante në botë.

Një mace / qen që të luaj me të.

Një dhomë time..

Një shtëpi më të bukur.

Një qytet më të pastër.

b. Në ëndërr kam parë se:

Kam shkuar të vizitoj Kalanë e Rozafës në Shkodër.

Pranë shtëpisë sime qëndronte një kotele e bardhë.

Në dhomën time raftet ishin të mbushura me libra.

Kopshti i shtëpisë sime ishte përplot me lule

shumëngjyrëshe.

Qyteti im u zgjodh qyteti më i pastër në botë

5. Shkruani ëndrrat dhe hobetë e juaja. Çfarë ëndërron të kesh në një kohë të afërt dhe çfarë kur të rritesh?



6. Shkruani se çfarë dëshironi të bëheni kur të rriteni? Pse?



7. Zakonisht kujt ia tregon ëndrrat? Po ty kush ti tregon ëndrrat zakonisht?



8. Dëgjoni me vëmendje tri rrëfime lidhur me ëndrrat. Cila prej ëndrrave të dëgjuara është ëndrra e gjyshit, cila është e këpucëtarit e cila ëndërr është e pilotit. Përgjigjet shkruani në kutia boshe sipas radhës.



1.

2.

3.

9. Dalloni përemrat pronorë.

libër



Duhet të dimë: Përemër pronor tregon se sendi i dhënë i përket një vete të caktuar: jastëku im, gjyshja ime, ëndrrat e mia etj. Përemrat pronorë kanë kategoritë gramatikore të vetës, të gjinisë, të numrit dhe të rasës.

Veta e parë				Veta e dytë			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
M	F	M	F	M	F	M	F
im	ime	e mi	e mia	yt	jote	e tu	e tua

Veta e tretë							
Njëjës				Shumës			
M		F		M		F	
i tij	i vet	e tij	e vet	e tij	e veta	të tij	të saj
i saj		e saj		e saj			

10. Lexoni fjalitë e dhëna me vëmendje dhe nënvizoni përemrat pronorë.



Vizatimi im është i bukur sepse kam vizatuar vendlindjen time.

Mësuesi ynë na bën ta duam matematikën më shumë.

Shoku yt dje nuk erdhi në kurs të gjuhës shqipe.

Prindërit e tu dje i takova në treg.

Gjyshi i saj dje bleu gazetën ditore.

Qeni i tyre theu saksinë e madhe.

11. Shkruani përemrat pronorë sipas fjalive të dhëna më sipër.

_____	_____
_____	_____
_____	_____

12. Dëgjoni dhe lexoni dialogun "Ëndrra e fluturës pikaloshë".



Një ditë prej ditësh një qukapik duke çukitur krimba në një lls sheh një flutur pikaloshë duke dalë nga lava e saj.

Qukapiku: Përsëndetje flutur pikaloshë!

Flutura pikaloshë: Përsëndetje i dashur! Cili je ti? Pse më quan flutur pikaloshë?

Qukapiku: Sepse në krahët e tua janë të pikturuara pika shumë të bukura. Më falë, harrova të prezantohem unë jam qukapiku.

Flutura pikaloshë: Sa bukur që është këtu o qukapik dhe sa shumë lule që ka.

Qukapiku: Këtu është parajsja vetë. Mirëpo, a e di se jetëgjatësia e fluturave është shumë e shkurtër ndërsa në botë ka aq shumë lloje të ndryshme lulesh.

Flutura ishte e mahnitur nga bukuria dhe aroma e këndshme e luleve përreth. Ajo fluturonte lule më lule.

Qukapiku: Dëgjo mikun plak flutur pikaloshë, secili ka ëndrrën e vetë.

Flutura pikaloshë: Nuk të kuptova?!

Qukapiku: Ndjek ëndrrën tënde kështu që shëtite botën.

Në formë falënderimi flutura pikaloshë i buzëqeshi mikut të saj dhe i rrahu krahët e fluturoi.

Qukapiku: Vetëm në Antartik mos shko ...

13. Përgjigjuni pyetjeve sipas dialogut të më sipërm:

1. Si u takuan qukapiku dhe flutura pikaloshe?
2. Për çfarë biseduan këta dy miq?
3. Çfarë donte të thoshte qukapiku me fjalinë "Ndjek ëndrrën tënde"?
4. Cili është mendimi yt se pse miku e këshilloi fluturën që të mos shkojë në Antartik?

14. Në tregimin "Ëndrra e fluturës pikaloshe" përpos përemrave pronorë që janë të nënvizuar mundohuni t'i gjeni edhe lidhëzat. Tregoni se cilat lidhëza janë aty.

15. Hulumtoni të dhëna mbi fluturat dhe shkruani të gjitha ato informacione duke iu treguar shokëve / shoqëve të klasës. Mos harroni t'i përdorni drejt lidhëzat në fjali.

16. Krijoni në klasë albumin e fluturave. Llojet e fluturave që ke gjetur ti vendosi në kutinë boshe.

17. Plotësoni këtë pyetësor por ju lutemi të jeni të sinqertë në përgjigjen e pyetjeve.



Emri:

Mbiemri:

Shkolla:

Mosha:

Data e lindjes:

Shoku / shoqja më i / e mirë:

Libri i preferuar:

Filmi i preferuar:

Kënga e preferuar:

Këngëtari / këngëtarja i / e preferuar:

Shkrimtari / shkrimtarja i / e preferuar:

Cili është hobi yt:

Sporti i preferuar:

Kafsha e preferuar:

Lulja e preferuar:


Ushqimi i preferuar:

Pija e preferuar:

Cila është dëshira jote më e madhe?



A series of horizontal lines for writing, consisting of a solid top line, a dashed midline, and a solid bottom line, repeated down the page.



MËSIMI 10



**PLANETET – SISTEMI
DIELLOR**

1.

Mesoni emrat e planeleve.

liber




MERKURI




VENERA



TOKA




MARSI




JUPITERI



SATURNI



URANI




NEPTUNI



PLUTONI

2. Lexoni sqarimet dhe i radhitni planetet sipas radhës në sistemin diellor.



Sistemi Diellor

1. Merkuri është planeti më i afërt me Diellin dhe planeti më i vogël në Sistemin Diellor.
2. Venera është planeti i 2-të më i afër me Diellin dhe i 5-ti për madhësinë e tij.
3. Toka është planeti i 3-të i sistemit Diellor.
4. Marsi është planeti i 4-të më i afër me Diellin dhe i 7-ti për nga madhësia.
5. Jupiteri është planeti i 5-të më i afër me Diellin dhe më i madhi nga të gjithë tjerët.
6. Saturni është planeti i 6-të për nga largësia nga Dielli.
7. Urani është planeti i 7-të më i afër me Diellin dhe i 3-ti për madhësinë e tij.
8. Neptuni është planeti i 8-të në Sistemin Diellor.
9. Plutoni është shumë më i vogël se çdo planet tjetër.

Toka-Hëna

Hëna, është i vetmi Satelit Natyror që ka toka. Në të nuk gjendet asnjë aktivitet tektonik gjithashtu nuk gjendet edhe atmosferë.
Hëna është një "satelit".

3. Mësoni numrat rendore dhe bashkoni planetet sipas rradhes.

Libë

Duhet të dimë: Numrat si i pari, i dyti, i treti ...etj. në matematikë quhen numra rendorë dhe këta numra në gramatikë kanë funksionin e mbiemrave.



Këta numra përdoren shumë në jetën e përditshme. Këto numra shkruhen me numra dhe me shkrim. Për shembull:

i pari- i 1-ri
i dyti- i 2-ti
i treti- i 3-ti etj.

i 4-ti	I pari planet më afër me diellin është	Venera
i 1-ri	I dyti planet më afër me diellin është	Toka
i 3-ti	I treti planet më afër me diellin është	Saturni
i 7-ti	I katërti planet më afër me diellin është	Neptuni
i 5-ti	I pesti planet më afër me diellin është	Urani
i 8-ti	I gjashti planet më afër me diellin është	Merkuri
i 2-ti	I shtati planet më afër me diellin është	Marsi
i 6-ti	I teti planet më afër me diellin është	Jupiteri

4. Tregoni me disa fjale çtare dini ju rreth sistemit diellor. Bisedoni se bashku me shokët/shoqet dhe mësuesin/mësuesen.

A large writing area with horizontal lines and a background illustration of the solar system planets.



Kush është Yuri Gagarin?

Yuri Gagarin ka lindur më 9 mars 1934. Ai vjen nga një familje e cila ka punuar në fermë. Familja kishte katër fëmijë dhe Yuri ishte i treti prej tyre. Yuri në moshë të vogël kishte një interesim të veçantë për hapësirën dhe planetët. Më 1957 ai u martua me Valentina Goryacheva. Yuri ishte i pari njeri që udhëtoi në hapësirë më 12 prill 1961. Gjithashtu ai ishte i pari i cili e përshkoi orbitën e tokës. Pas këtij fluturimi Yuri fitoi një famë botërore. Më 27 mars 1968 Yuri Gagarin ka vdekur gjatë një fluturimi rutinë të forcave ajrore Ruse pasi morri flak avioni i tij.

Fermë:

Kozmike:

Rutinë

Hapësirë:

Orbitë:

Forcë:

Avion:

Përshkim:

Ajrore:

Anije:

Fluturim:

Flak:

1. Kur ka lindur Yuri Gagarin?

2. I sati fëmijë është ai?

3. Ku kanë punuar prindërit e tij?

4. Për çfarë është interesuar ai në rinë?

5. Kur është martuar Yuri Gagarin?

6. Kur ka vdekur Yuri Gagarin?

7. Si ka vdekur Yuri Gagarin?



E bija e Hënës dhe e Diellit

Na ishte njëherë, diku në një fshat, një gjahtar trim që jetonte vetëm me nënën e tij. Nënë e bir jetonin në varfëri dhe djali e nxirrte bukën e gojës vetëm me gjueti në mal. Dikur në shpellat e malit u shfaq një kuçedër shumë e egër që vriste dhe hante çdo gjë të gjallë që shikonte. Njerëzit në fshat, të cilët jetonin më shumë me gjuetinë në mal, filluan të vuanin nga uria. Askush nuk guxonte më të shkonte në mal për të gjuajtur. Kuçedra e egër kishte ngrënë mjaft nga djemtë e fshatit. Gjuetari jonë trim vendosi dhe u nis për ta vrarë Kuçedrën në mal. Sepse nusja e tij kishte kërkuar që ai ta vriste kuçedrën. Gjahtari trim, ngaqë e donte vajzën me shpirt, dëshironte t'ia plotësonte të gjitha dëshirat. Por kuçedra nuk kishte mëshirë për asnjë njeri. Kuçedra filloi të tallej me djalin që sapo ishte futur në strofullin e saj me shpatë në dorë. Ndërsa djali u bë gati ta godiste me shpatë, kuçedra e tërbuar vetëm një herë e goditi Tokën me forcë, me bishtin e saj gjigand, dhe malli u drodh. Djali i ra shpata nga dora dhe mbeti i paarmatosur përballë kuçedrës.

- Tani e kam gati darkën me mish njeriu, - mendoi kuçedra e gëzuar dhe u bë gati ta copëtonte djalin.

- Ndal të lutem!- i tha djali. Kur ika, nuk munda të përshëndes nënën dhe nusen time dhe do të kisha dëshirë që t'u them lamtumirë miqve dhe shokëve.

Kuçedra e vërejti me sy mosbesues, por djali i dha besën se do të kthehej përsëri. Kuçedra e dinte se kur dikush në fshat e jepte besën, e mbante sikur edhe të vdiste.

-Mirë, shko,- i tha Kuçedra, Por nesër në mëngjes herët dua që të jesh këtu.

-Ta jap besën time,- i tha djali dhe u nis për në fshat. Me lot në sy, pasi u nda nga e nëna, u nis për ta takuar nusen e dashur. Kur nusja e mori vesh se çfarë kishte ndodhur, tha me vendosmëri:

-Do të shkojmë bashkë tek Kuçedra në mal.

Kur në vend të një njeriu kuçedra pa dy veta para shpellës së saj u gëzua shumë.

-Ohohoho,- tha e gëzuar,- nga një më u bënë dy!

- Nga një nuk ke asnjë, - u përgjigj nusja me guxim. Unë jam bija e Hënës dhe e Diellit. Fjala ime sjell jetën dhe jo vdekjen. Mallkimi im bie mbi këdo që mundohet të sjellë vdekjen. Ti, o kuçedër, sjell vdekje prandaj unë të urdhëroj ty të shkosh përsëri andej nga ke ardhur. Shko në ferr dhe digju përjetë! Në momentin që vajza i tha këto fjalë, toka u hap, dhe flakë e vullkan përpinë kuçedrën dhe kuçedra u zhduk në fund të gropës së madhe të hapur midis shpellës. Djali u gëzua shumë dhe e mori nusen në krah deri në fshat. Atje ai tepër i gëzuar i dha dy lajme të mira nënës së tij të dashur. Nusja e tij është bija e Hënës dhe e Diellit. Kuçedra në mal është zhdukur përgjithmonë. Njerëzit në fshat u gëzuan shumë dhe të gjithë morën pjesë në dasmën e gjuetarit. Që nga ajo ditë, jeta në fshat vazhdon e lumtur.

Mitrush Kutell

a. Nxirrni fjalët e panjohura nga teksti dhe i shkruani ato si detyrë shtëpie.





b. Tregoni me disa fjalë: a keni edhe ju në gjuhën tuaj një përrallë të tillë dhe çfarë mendoni rreth kësaj përralle.



7.

Beni një analizë të tregimit popullor "Bija e Hënës dhe e Diellit".



1. Dallo në tekst hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen. Trego fjalitë e para të paragrafëve.

Hyrje:

Zhvillim:

Mbyllje:

2. Çfarë lloj tregimi është ky tregim që dëgjuat dhe lexuat; realist ose fantastik?

Nëse është realist tregoni me disa fjalë përse?

Nëse është fantastik tregoni me disa fjalë përse?

3. A mund të komentoni veprimin e gjuetarit me disa fjalë?

4. A mund të komentoni veprimin e nuses me disa fjalë?



Duhet të dimë: Dielli është një yll. Por dielli nuk është aq i vogël sa yjet sepse është më afër nga yjet me Tokën. Dielli është shumë i madh dhe i rumbullakët. Madhësia e Diellit është sa një milion Toka së bashku.



Dielli

Tani të imagjinojmë sikur me anijen kozmike tonë po i afrohem Diellit. Ai duket si një top i madh gjigant plot me re. Por këto re nuk janë si ato që ju shikoni në qiell në një ditë me diell. Ato nuk janë as si retë në një ditë me shi. Këto re janë ngjyrë portokalli, të verdha dhe të bardha. Edhe në qoftë se do të mund t'i afroshim Diellit, nuk do të arrinim të shihnim asgjë, sepse Dielli është shumë i ndritshëm. Ju asnjëherë nuk duhet ta shikoni atë drejtpërdrejt, sepse mund të ju dëmtohen sytë.

Ne nuk mund të afrohem më pranë tij, sepse Dielli është shumë i nxehtë. Të mendojmë për disa gjëra që janë të nxehta. Të mendojmë për një ditë vere të nxehtë ose për rërën e plazhit që djeg. Të mendojmë për zjarrin. Të mendojmë për furrën, ku mamaja e juaj pjek byrekun. A janë ata më të nxehtë se sa një yll i nxehtë? Jo. Dielli është shumë më i nxehtë. Çfarëdo që të mendoni, asgjë nuk është aq i nxehtë se sa Dielli.

9. Përgjiguni sipas tekstit të mesipërm "Dielli".



1. Me çfarë po i afroheni Diellit?

2. Si duket Dielli?

3. Çfarë ngjyre janë retë?

4. Përse nuk e shikojmë dot ne Diellin drejtpërdrejt?

5. Përse nuk i afrohem dot Diellit?

10. Mesoni dy fjalë të urta për Diellin. Ndërsa dy të tjera i shkruani në gjuhën tuaj.



Edhe diell të bëhesh, të gjithë nuk i ngroh dot!

Dielli është jorgan i të varfrit.



A series of horizontal lines for writing, consisting of a solid top line, a dashed middle line, and a solid bottom line, repeated down the page.

A blank sheet of white paper with a dashed brown border. The page is filled with horizontal blue lines, typical of a notebook page. There are 25 lines in total, spaced evenly down the page. The paper is slightly tilted to the right.

MËSIMI 11



SHKENCË

1. Dëgjoni me vëmendje dhe lexoni tekstin e mëposhtëm.



Isaac Newton

Isaac Newton ka lindur më 4 janar 1643 dhe ka vdekur më 31 mars 1727. Ai ishte një fizikan i rëndësishëm. Njëkohësisht ai ishte edhe matematikan, astronom dhe filozof. Ai është shumë i famshëm në botë sepse bëri një zbulim të rëndësishëm të fizikës. Newtoni zbuloi gravitetin nga rënja e një molle prej pemës. Me këtë zbulim shkencë është zhvilluar. Ai ishte një njeri shumë i mençur.



2. Përgjiguni pyetjeve sipas tekstit në ushtrimin 1 dhe mundohuni t'i gjeni nga fjalori fjalët që nuk i dini.



1. Kush është Isaac Newton?

2. Kur ka lindur dhe kur ka vdekur Isaac Newton?

3. Përse është i famshëm Isaac Newton?

4. Si ka ndikuar zbulimi i tij një shkencë?

5. Çfarë dini ju për gravitetin? Bisedoni në klasë.

Fjalët që nuk i dini:

Fizikan:	Gravitet:
Matematikan:	Zbulim:
Filozof:	Zhvillim:

3. Shikoni figurat dhe bashkoni shpikjet me shkencëtarët. Nëse nuk i dini pyetni familjen ose mësuesin/mësuesen.



1. Piri Reis



2. Fatih Sultan Mehmet




3. Alexander Graham Bell



4. Alva John Fisher



5. Arkitekt Sinani



6. Arkimedi



a. Telefon



b. Hartë



c. Xhami



d. Lavatriçe



e. Trapan



f. Top Shahi



4.

Alba dhe Emre po diskutojnë në klasë në lidhje me shkencën. Lexoni tekstin, pastaj ndahuni në grupe dyshë dhe krijoni edhe ju një dialog në lidhje me shkencën.



Alba: A keni ju telefon në shtëpi Emre?

Emre: Po, ka mami edhe babi telefon.

Alba: Jo, Emre nuk po pyes për telefon celular por për telefon shtëple.

Emre: Jo, ne nuk kemi telefon shtëple. Tani përdoren më shumë celularët.

Alba: Atëherë mund të themi se teknologjia ka përparuar shumë?

Emre: Po patjetër. Teknologjia po vazhdon të zhvillohet. Për shembull në të ardhme mund të përdorim diçka tjetër për të komunikuar.

Alba: Si mendon ti Emre, a është mirë zhvillimi i teknologjisë dhe i shkencës për njerëzit?

Emre: Unë mendoj se po!



A: _____

B: _____

A: _____

B: _____

A: _____

B: _____

A: _____

B: _____



Mrekullitë e shkencës

Shkenca e ka ndryshuar të gjithë botën. Shkenca e ka bërë jetën tonë më të sigurtë dhe më me pak probleme. Prandaj shkenca është e dobishme për ne. Shkenca ka qenë në çdo kohë dhe vazhdon të jetë. Për shembull energjia elektrike është një dhuratë e mrekullueshme e shkencës.

Energjia elektrike përdoret në çdo vend të jetës. Për shembull për të larë roba, për të gatuar ushqim dhe për të jetuar. Vendet e përdorimit të saj janë të pakufizuara. Elektri ndriçon shtëpitë, dyqanet dhe rrugët tona. Ai na mban të ngrohtë në dimër dhe të freskët në verë. Edhe udhëtimi tani është më i shpejtë dhe më i sigurt. Me ndihmën e rrymës elektrike ne mund të udhëtojmë me tren, makinë, aeroplan, metro etj. Kështu që ne mund të shkojmë në çdo vend të botës.

Shkenca ka ndikuar edhe në shëndet dhe njerëzit tani janë më të shëndetshëm. Me ndihmën e shkencës njeriu ka arritur edhe në hënë. Nuk ka kufi për mrekullitë e shkencës.



Pyetjet:

1. Si ka ndikuar shkenca në botë? Mirë apo keq?

2. Cila mund të jetë njëra prej dhuratave të shkencës?

3. Çfarë mendoni ju? A ka kufi shkenca apo jo?

6. Dëgjoni tekstin me vëmendje dhe rrethoni fjalën e saktë që dëgjoni.



Stephen Hawking

